

 Republika e Kosovës	Drejtoria për Emergjencë Mbrojtje dhe Shpetim Sherbimi zjarrfikësve dhe Shpetimit Zyra e parandalimit dhe hulumtimit të zjarrit Datë: 24.06. 2025 08 Nr.15/2025	 Komuna e Istogut
--	--	---

Në mbështetje të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 08/L-261 neni 19 si dhe Vendimit për formimin e shtabit komunal për korrje - shirje Nr.01-567/2025 i datës 19.06.2025, Drejtoria për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpetim me qëllim që paraprakisht të ndermirren masat e parapara parandaluese dhe operuese për mbrojtje nga zjarri nxjerr këtë shkresë:

N J O F T I M

Përmes këtijë njoftimi informojmë kombajneret, prodhuesit dhe deponuesit e grurit: që të ndermirren të gjitha masat e domosdoshme dhe të nevojshme parandaluese dhe operuese për mbrojtje nga zjarri, gjatë fushatës së korrje – shirjeve të sivjetme ashtu që të perfundoj pa ndonjë fatkeqësi të kësaj natyre. Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari ligjërisht është bartës i këtijë aktiviteti. Më poshtë janë dhënë udhëzimet të cilat janë obligative për kombajneret prodhuesit dhe deponuesit e grurit.

Masat që duhet ndermarë janë si më poshtë:

1. Formimi i komisioneve për korrje -shirje
2. Kontrollimi i mjeteve teknike (makinerisë) së angazhuar.
3. Aplikimi i metodave të veçanta për korrjen e sipërfaqeve të mëdha
4. Transporti dhe deponimi.
5. Respektimi i rept i këshillave për parandalim në vendpunishte.

1. Formimi i komisioneve për korrje -shirje:

- Formimi i komisioneve nëpër bashkësit lokale (me që komisioni komunal është formuar) me qëllim të përcjelljes së mbarëvajtjes së fushatës, dhe të informoi lidhur me situatën).
- Në këtë komision personeli duhet të ketë përvojë praktike dhe teorike në lëmin e mbrojtjes nga zjarri.

2. Formimi i komisioneve për korrje -shirje:

- Gjendja e mirë e autokombajnave, paisja e tyre me mjete mbrojtëse nga zjarri (aparati P-9, kazma dhe dy lopate)
- Sigurimi i rojeve në vendin e punës (24 orëshe nëse teknika mbetet në teren).
Në kuader të këtyre masave duhet të cekët se teknika duhet mirëmbahet, nuk guxon të jetë e përlyer me naftë dhe derivate të saj, pastrimi i rregullt i filtrave të mekanizmit fshirës dhe servisimi nuk guxon të kryhet në mes të grunajës por duhet të terhiqet deri në një vend të sigurt, gjithashtu furnizimi me karburant bëhet në vendin e sigurt.

3. Aplikimi i metodave të veçanta për korrjen e sipërfaqeve të mëdha :

- Siperfaqet e mëdha të ndahen me shirita të korrura.
- Të angazhohen traktoret që të lavrohen shiritat në mënyrë që në rast zjarri të mos perhapet.
- Të jetë e angazhuar një auto cistern me pomp dhe tubacion në këto sipërfaqe, ashtu që të kujdestaroi dhe të bëjë intervenimin e parë në rast nevojë.

4. Transporti dhe deponimi.:

- Transporti i shpejt dhe efikas i drithit nga grunaja deri në deponi
- Deponimi në vendet e duhura, dhe nëse dyshohet së drithi ka lagështi atëherë të degjohen me kujdes këshillat profesionale të inxhinierve për mënyren e deponimit, të mos deponohet në grumbuj të mëdhenjë por në grumbuj më të vegjel që të ketë mundësi ajrosjeje apo edhe të derdhet në sipërfaqe nëse lagështija është e lartë dhe jo në një trashësi më të madhe se 0.5m të kontrollohet së paku 4 herë në ditë apo edhe më shpesh.

5. Respektimi i rrept të këshillave për parandalim në vendpunishte:

- Të mos pihet duhan në grunajë dhe autokombajë, të largohen personat e papergjegjshëm nga vendpunishtja.
- Të mos pardoren mjetet me flakë të hapur apo edhe ato që prodhojnë shkëndija, qofshë për riparime apo aktivitetet tjera pune.
- Manipulimi me kujdes, dhe nga persona të rritur me naftë dhe derivate të saj.

Me këtë vendim do të jenë të njoftuar të gjithë fermerët dhe kombajnëret e komunës sonë. Mos respektimi i masave të cekura më lartë do të pasojë me ndërprerje të punës në vendin e ngjarjes dhe gjobitjen sipas ligjit në fuqi.

Një kopje e këtijë njoftimi i jepet edhe Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari si bartëse e këtijë aktiviteti.

Për çdo rast emergjent, zjarrë apo fatkeqësi tjetër thirrni numrin emergjent 112

Inspektori i parandalimit

Haki Belaj

.v.v

Drejtori

Xhevat Demaj

